



PLANI I INTEGRITETIT

**Bashkia Berat**

**2025-2028**

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 67 Datë 12.09 2025



### GRUPI I PUNËS PËR HARTIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT NË BASHKINË BERAT

Arisa Toska, Sekretare e Përgjithshme, Koordinatore e Grupit të Punës për Integritetin  
Petro Sinjari, Drejtor Juridike, anëtar  
Rovena Shehu, Drejtor i Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, anëtare  
Sokol Toska, Drejtor i Emergjencave, Pronave, Transportit dhe Sherbimeve, anëtar  
Gentian Dashi, Drejtor i Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve Mbështetëse, anëtar  
Marius Qytyku, Drejtor i Integritetit Europian dhe Projekteve, anëtar  
Jorida Papa, Specialist i Statistikës, anëtare

### GRUPI I PUNËS AMVV

Julian Uzeir, Përgjegjës i Sektorit të Trajnimeve dhe Konsultimit, Drejtoria e Trajnimit dhe Fuqizimit të Kapaciteteve

Ema Minxolli, Përgjegjës i Sektorit të Vlerësimit të nevojave dhe Hartimit të Kurrikulave ....

Majlinda Rriska, Eksperte e jashtme

Ajdi Lajthia, Specialist, Sektori i Financës dhe Sherbimeve Mbështetëse

*Ky plan integriteti është hartuar në kuadër të Komponentit "Zgjerimi i praktikës standarde të planifikimit të integritetit në nivel vendor" "Mbështetja dhe avancimi i reformave të qeverisjes vendore", në bashkëpunim me AMVV dhe me mbështetjen e Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor*

## **Deklarata e Integritetit Institucional**

Forcimi i integritetit përbën themelin e një administrate vendore transparente, të ndershme dhe profesionale, e cila vepron në shërbim të qytetarëve dhe synon të fitojë besimin e tyre. Duke u mbështetur në këtë parim, Bashkia Berat ka ndërmarrë hapa konkretë për të rritur rezistencën institucionale ndaj korrupsionit dhe për të përmirësuar ndjeshëm nivelin e transparencës, llogaridhënies dhe cilësinë e shërbimeve publike. Në këtë kuadër, është hartuar Plani i Integritetit për periudhën 2025–2028, si një instrument strategjik për të konsoliduar qeverisjen e mirë dhe për të garantuar një administratë vendore më të përgjegjshme dhe më efikase në shërbim të komunitetit.

Të qeverisim mirë është gjithë sfida jonë. Duke pranuar se një nga kërcënimet kryesore të mirëqeverisjes është korrupsioni, jemi të ndërgjegjshëm për ndikimin negativ të këtij fenomeni në zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik të komuniteteve vendore, bashkisë dhe vendit. Për këtë arsye, bashkia e Beratit që unë përfaqësoj, i bashkohet përpjekjeve antikorruption të aktorëve të ndryshëm, të udhëhequra nga Qeveria Shqiptare për të kontribuar për një shoqëri me kulturë demokratike, vizion dhe integritet të lartë. Ndaj, si Kryetar i Bashkisë mbështes përpjekjet për integritet, transparencë dhe llogaridhënie për parandalimin e korrupsionit në institucionet e qeverisjes vendore, duke bërë shembull bashkinë që vetë drejtoj.

Jemi të ndërgjegjshëm për ecuritë dhe arritjet pozitive në punën tonë në këto vite. Kemi përmirësuar transparencën e veprimtarisë sonë dhe vendimmarrjes bashkiake falë përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe instrumenteve si Programi i Transparencës, Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve në faqen zyrtare të bashkisë, mbledhjet online të këshillit bashkiak, apo vendimeve të publikuara në [vendime.al](http://vendime.al); kemi krijuar zyrat OSSH, për shërbime të përqendruara dhe të shpejta për qytetarët; kemi përmirësuar konsultimet me grupet e interesit; kemi automatizuar shumë procese administrimi të taksave të ndryshme duke ulur mundësitë për korrupsion e shumë arritje të tjera. Por, jemi të ndërgjegjshëm se ende ka punë të tjera për të bërë dhe për të përmirësuar në lidhje me forcimin e integritetit dhe etikës në institucionin e bashkisë, forcimin e masave të kontrollit në proceset e punës, administrimin eficient të burimeve, forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator, vendosjes së interesit publik mbi gjithçka, përmirësimin e standardeve të shërbimeve dhe luftës ndaj korrupsionit. Në të gjitha këto, e dimë se risqet dhe faktorët e tyre janë komplekse dhe mund të jenë financiare, strategjike apo të lidhura me burimet njerëzore etj.

Duke menaxhuar jetën publike në nivel vendor, financat dhe asetet publike, burimet njerëzore dhe natyrore dhe të tjera burime, në kuadër të një procesi të decentralizimit të vazhdueshëm që thellohet me kalimin e kohës, duke zgjeruar funksionet e qeverisjes vendore, e kuptojmë rrezikun për shkelje të integritetit, duke krijuar hapësira për shkelje dhe korrupsion. Të dedikuar ndaj mirëqeverisjes dhe të orientuar drejt rritjes së besimit qytetar, u angazhuam në këtë mundësi të ofruar nga IDM për planifikimin e integritetit si një mundësi për të rritur njohuritë dhe aftësitë institucionale, për të identifikuar dhe vlerësuar risqet e cënueshmërisë së integritetit dhe pasur instrumente efektive

për të forcuar rezistencën institucionale ndaj shkeljeve të integritetit dhe korrupsionit. Zbatimi i masave të planit, do të mundësojnë një mjedis institucional që promovon kulturën e integritetit bazuar në funksionimin e sistemit të menaxhimit të riskut të integritetit. Masat e përfshira në këtë plan do të përmirësojnë performancën e bashkisë, veçanërisht efikasitetin, efektivitetin, transparencën dhe etikën.

Ervin Ceca  
KRYETAR I KOMANDUAR I BASHKISË

## SHKURTESA

|             |                                                   |
|-------------|---------------------------------------------------|
| <b>AMVV</b> | Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore |
| <b>ASPA</b> | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike         |
| <b>BNJ</b>  | Burime Njerëzore                                  |
| <b>BE</b>   | Bashkimi Evropian                                 |
| <b>DAP</b>  | Departamenti i Administratës Publike              |
| <b>GPI</b>  | Grupit të Punës për Integritetin                  |
| <b>KI</b>   | Konflikti i Interesit                             |
| <b>NJVV</b> | Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore                  |
| <b>PBA</b>  | Programi Buxhetor Afatmesëm                       |
| <b>PI</b>   | Plani i Integritetit                              |
| <b>PPV</b>  | Plan i Përgjithshëm Vendor                        |
| <b>PSV</b>  | Procedura Standarde Veprimi                       |
| <b>OGP</b>  | Parimet e Partneritetit për Qeverisje të Hapur    |

## TABELA E PËRMBAJTJES

|                                                                                               |   |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------|---|
| 1. Rëndësia e Planit të Integritetit .....                                                    | 6 |
| 1.1 Hartimi i Planit të Integritetit .....                                                    | 6 |
| 1.2 Qasja metodologjike .....                                                                 | 8 |
| 2. Objektivat e identifikuara dhe niveli i përgjithshëm i cënueshmërisë së integritetit ..... | 9 |
| 3. Plani i veprimit.....                                                                      | 9 |



## **1. Rëndësia e Planit të Integritetit**

Plani i Integritetit paraqet një mjet të rëndësishëm për forcimin e mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ai është një dokument strategjik dhe operacional, që është produkt i procesit të vlerësimit të riskut të integritetit. Plani i Integritetit 2025–2028, vijon dhe përmirëson përvojën e akumuluar nga Plani i parë i Integritetit 2022–2024, i cili ishte iniciativa e parë e bashkisë për menaxhimin e riskut të integritetit në nivel vendor.

Plani i Integritetit 2025-2028, si një instrument menaxhimi për parandalimin e korrupsionit u hartua duke u bazuar në konkluzionet dhe rekomandimet e raportit të monitorimit të planit të mëparshëm i cili hodhi themelet në drejtim të: krijimit të standardeve etike në institucion; rritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore për çështjet e integritetit; përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies publike dhe duke marrë në konsideratë risqet e mbetura, si dhe vlerësimin e risqeve të reja të integritetit.

Qëllimi i këtij plani është të krijojë dhe konsolidojë një administratë vendore, transparente, inovative dhe të përgjegjshme për qytetarët, ku Këshilli Bashkiak (KB), administrata dhe shoqëria civile bashkëqeverisin në mënyrë etike, duke krijuar një administratë vendore që i kundërvihet korrupsionit.

Vlerësimi u zhvillua nga grupi i punës i ngritur me urdhrin Nr.510, datë 14.07.2025 të Kryetarit të Bashkisë, ku bënë pjesë përfaqësues të administratës së institucionit, të cilët u asistuan nga ekipi i punonjësve dhe ekspertëve të AMVV, gjatë periudhës korrik- gusht 2025.

### **1.1 Hartimi i Planit të Integritetit 2025-2028 u bazua në:**

1. Kuadrin bazë të politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore si:

- Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030 dhe Plani i Veprimit 2024–2026
- Strategjia Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030 dhe plani i saj i veprimit 2023-2025;
- Rekomandimet e GRECO-s (Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit) për forcimin e integritetit në nivel vendor;
- Parimet e Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP Local), të cilat sigurojnë pjesëmarrje të gjerë qytetare, transparencë dhe llogaridhënie;
- Aktet e reja nënligjore në fushën e etikës transparencës, menaxhimit të riskut dhe qeverisjes vendore.

### **Hartimi i Planit të Integritetit në Bashkinë Berat kaloi në fazat e mëposhtme:**

Procesi u bazua në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (MVRI), hartuar nga IDM në vitin 20219, si dhe udhëzuesin praktik për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore (IDM 2024). Stafi i bashkisë u angazhua përgjatë gjithë procesit të planifikimit të integritetit dhe vlerësimit të riskut, pëmes përdorimit të disa instrumenteve që MVRI udhëzon.

Në përputhje me Udhëzimet e MVRI-së, procesi i planifikimit të integritetit kaloi në fazat e mëposhtme:

#### **Faza 1: Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzore**

Plani i Integritetit është në thelb një instrument vetëvlerësimi i institucionit dhe një strategji masash të cilat konsiderohen të realizueshme, ndaj hapi i parë i procesit të hartimit të planit të integritetit konsiston në ngritjen e grupit të punës me përfaqësues nga administrata të cilët mbulojnë fushat kryesore të funksioneve të bashkisë me. Grupi i punës, pasi u prezantua me Metodologjinë për Vlerësimin e Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) dhe me hapat e punës, u trajnua mbi çështjet e integritetit dhe etikës në administratën publike. Së fundi, në këtë fazë pasi u analizua raporti i monitorimit të planit të mëparshëm dhe u vlerësuan risqet e mbetura, u bë komunikimi i qëllimit dhe objektivave të Planit të ri Integritetit me administratën e bashkisë nga ana e Grupit të Punës

#### **Faza 2: Identifikimi dhe analizimi risqeve të integritetit**

Gjatë kësaj faze Grupi i punës, pasi shqyrtoi dhe mori në analizë raportin e monitorimit të planit të mëparshëm për të analizuar risqet e mbetura, shqyrtoi kornizën rregullatore dhe strategjike, si dhe dokumente të ndryshme operative të bashkisë. Grupi i Punës vijoi me identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, për proceset e punës në fushat funksionale të bashkisë. Me qëllim mbledhjen e të dhënave cilësore, në këtë fazë u zhvilluan 7 fokus grupe me punonjësit e bashkisë sipas fushave të kompetencave të përgjithshme dhe funksionale. Në këtë fazë, punonjësit e administratës plotësuan një pyetësor në mënyrë anonime, në formë elektronike për të siguruar të dhëna dhe informacione për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të integritetit. Ky pyetësor u plotësua nga 82 përfaqësues të administratës së bashkisë.

#### **Faza 3: Vlerësimi i risqeve të integritetit**

Grupi i Punës në bashkëpunim me punonjësit dhe ekspertët e AMVV bëri vlerësimin e risqeve të integritetit. Risqet e identifikuara u vlerësuan në lidhje me:

- Mundësinë e ndodhjes së një ngjarjeje të padëshiruar në mungesë të aktivitete të kontrollit ose kur ato janë të pamjaftueshme për të parandaluar apo ulur riskun;
- Pasojën që një ngjarje e padëshiruar do të kishte në bashki nëse do të ndodhte.

Bazuar në mundësinë së ndodhjes dhe ndikimin e tyre, risqet u kategorizuan në nivele të ndryshme (i lartë, mesatar, i ulët) dhe u renditën sipas prioritetit.

#### **Faza 4: Plani i masave për menaxhimin e integritetit dhe trajtimi.**



Procesi i identifikimit dhe vlerësimit të risqeve të integritetit shërben për vetëdijësimin e stafit për problematikat e hasura gjatë ushtrimit të punës së tyre. Grupi i punës pasi analizoi rrisqet e mbetura nga plani i mëparshëm, risqet e reja dhe ndryshimet ne procedurat e bashkisë hartoi planin e veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit në institucion, i cili përfshiu masa të reja kontrolli apo përmirësimin e masave ekzistuese. Masat përshkruajnë aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore, përgjegjësitë organizative si dhe kostot e planifikuara për zbatimin e tyre. Në përfundim të fazës së renditjes së risqeve sipas prioriteteve, grupi i punës diskutoi mbi hartimin e një plani me masa konkrete për adresimin e risqeve të evidentuara. Ky Plan Veprimi përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit të identifikuar sipas fushave të përgjegjësisë afatet kohore dhe strukturat përgjegjëse. Ai është një mjet plotësues i politikave dhe kornizës rregullore për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional.

Plani i Integritetit do të fillojë zbatimin pas miratimit nga Këshilli Bashkiak.

## 1.2 Qasja Metodologjike

Hartimi i Planit të Integritetit për Bashkinë Berat u realizua në përputhje me metodologjinë për vlerësimin e riskut në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, duke ndjekur një qasje të kombinuar cilësore dhe sasiore.

### 1. Instrumentet cilësore:

- Analizën e zbatimit të planit të mëparshëm duke u bazuar në raportin e monitorimit konkretisht ne konkluzionet dhe rekomandimet e tij;
- Analizën e kuadrit të brendshëm rregullator:

Kjo analizë shqyrton nëse bashkia ka zbatuar kërkesat ligjore dhe rregulloret e brendshme, duke përfshirë:

- Shqyrtimi i përputhshmërisë së kuadrit rregullator të bashkisë me legjislacionin në fuqi.
- Verifikimi nëse bashkia disponon dokumente kyçe si:
  - Rregullore të brendshme që përmbajnë përshkrimet e punës dhe zinxhirin e llogaridhënies.
  - Rregulla për etikën dhe parandalimin e konfliktit të interesit.
  - Strategji, urdhra, dhe procedura të tjera që ndihmojnë në zbatimin e kërkesave ligjore dhe rritjen e transparencës.

### 2. Instrumentet sasiore:

- Diskutimet me stafin e bashkisë në grupe të fokusuara

Gjatë fokus grupeve u trajtuan risqet e mbetura dhe problematikat që mund të përbëjnë risk për integritetin gjatë praktikës së punës së tyre, si dhe nevojat për trajnim dhe kualifikime shtesë, apo mangësi në burimet financiare.

- Pyetësor i strukturuar

Ky instrument ka për qëllim të matë perceptimet e nëpunësve të bashkisë lidhur me funksionimin dhe efektivitetin e sistemit të menaxhimit të integritetit. Pyetësi përfshin pyetje të fokusuar në çështje të veçanta të integritetit dhe etikës në administratën e bashkisë, u plotësua në mënyrë anonime për të garantuar lirinë e shprehjes dhe besueshmërinë e rezultateve. Procesi i anketimit përfshiu një kampion prej 82 nëpunësish bashkiakë, bazuar në parimin e përzgjedhjes dhe raportimit vullnetar nga stafi.

Nga aspekti gjinor, zyrtarët meshkuj përbëjnë 24.4 % të kampionit, ndërsa zyrtaret gra përfaqësojnë 75.6%. Sa i përket grupmoshave, kategoria më e përfaqësuar është ajo e moshës 36-45 vjeç 37.8%, e ndjekur nga grupmosha 26-35 vjeç 36.6%. Grupmoshat 46-55 vjeç 15.9 dhe mbi 56 vjeç përbëjnë përkatësisht 4.9 % të kampionit, ndërsa nëpunësit deri në moshën 25 vjeç përfaqësojnë vetëm 6.1%.

Në aspektin e përvojës profesionale, nëpunësit me më pak se 5 vite përvojë pune përbëjnë 43.9% të kampionit. Kategoria me 5-10 vite përvojë përfaqëson 41.5 %, ndërsa nëpunësit me 11-20 vite përvojë përbëjnë 9.8 %. Grupet me 21-30 vite përvojë përbëjnë 3.7% të kampionit, ndërsa grupi me mbi 30 vite përvojë pune përbën vetëm 1.2%.

## **2. Objektivat e identifikuara dhe niveli i përgjithshëm i cënueshmërisë së integritetit**

*2.1 Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit*

*2.2 Forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit nëpërmjet konsolidimit të menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore në bashki.*

*2.3 Forcimi i transparencës, efikasitetit sipas fushave të përgjegjësisë dhe llogaridhënies publike të bashkisë;*

## **3. Plani i Veprimit**

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit të identifikuar sipas fushave të përgjegjësisë së bashkisë . Ai është një mjet plotësues i politikave dhe kornizës rregullatore për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional.

Monitorimi dhe raportimi i Planit të Veprimit është periodik (çdo vit) dhe pasqyron kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës për zbatimin e masave të miratuara. Procesi i zbatimit dhe monitorimi duhet të ndërthurë vetëvlerësimin institucional me verifikimin nga jashtë. Ky sistem synon të sigurojë që progresi ndaj objektivave të Planit të Integritetit (PI) të matet në mënyrë të rregullt, transparente dhe të krahasueshme në kohë. Ky proces ndiqet nga personi përgjegjës, i caktuar nga titullari i institucionit, i cili ndjek progresin e zbatimit.

Frekuenca minimale e raportimit është brenda një periudhe gjashtëmujore. Raportimi i lejon titullarit të ndërmarrë me kohë masa përmirësuese, në rast se zbatimi i ndonjë mase të caktuar ka sjellë vështirësi apo vonesa.

Koordinatori përgatit raportin përmbledhës vjetor, i cili pas miratimit nga Kryetari, i dërgohet AMVV-së dhe më pas publikohet në faqen zyrtare të bashkisë.



Matrica e Planit të Veprimit

| Objekivi 1: Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit |                                                   |                                  |                                                                  |                                                                                                                                                    |                                                                                                                                                                                                    |                    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------|------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| Nr.                                                                                                                    | Risku dhe ngjarjet e mundshme                     | Kategoria e faktorëve të riskut; | Prioritet i lartë;<br>Prioritet i moderuar;<br>Prioritet i ulët; | Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës;                                                                                           | Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve;                                                                                                            | Buxheti Indikativ; |
| 1                                                                                                                      | Mungon Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë. | Operacional/<br>Strategjik       | 1 Lartë                                                          | 1. Hartimi, konsultimi dhe miratimi i Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë;<br><br>2. Publikimi i këtij plani në Programin e Transparencës; | Grup Pune për hartimin e Planit Strategjik të Zhvillimit<br><br>Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik<br><br>Koordinatori për të Drejtën e Informimit<br><br>Gjashtëmujori i dytë 2027 |                    |
|                                                                                                                        | Mungon plani i mbarështrimit të pyjeve.           | Operacional/<br>Ligjor           |                                                                  | 1. Hartimi i urdherit të kryetarit të kryetarit të bashkisë, për ngritje e grupit të punës.<br>2. Njohja me praktikën e mira;                      | Gjashtëmujori i dytë 2028                                                                                                                                                                          |                    |



|   |                                                                                                                                                                                |                         |         | 3. Hartimi i planit;<br>4. Publikimi në faqen e web;                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                                                                                                         |  |
|---|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|---------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
| 2 | Rregullorja e brendshme e bashkisë ka nevojë të përditësohet dhe plotësohet me përshkrimin e disa pozicioneve, si GMSR, dhe të koordinatoreve.                                 | Operacional/<br>Procesi | I Mesëm | 1. Përditësimi (dhe miratimi) i rregullores së bashkisë;<br>2. Njohja e stafit të bashkisë me përcaktimin e plotë dhe të qartë të detyrave dhe linjave të komunikimit dhe hierarkisë ndërmjet strukturave të bashkisë sipas rregullores;<br>Drejtorja e Burimeve Njerezore                                                                                                     | Kryetari/Grup Pune<br>Gjashtëmujori i dytë 2025                                                         |  |
| 3 | Mungesa e Kodit të Sjelljes dhe Etikës si dokument më vete sipas modelit të miratuar.                                                                                          | Operacional/<br>Ligjor  | I Mesëm | 1. Hartimi dhe miratimi i Kodit të Sjelljes për administratën e bashkisë;<br>2. Informimi i personelit të bashkisë nëpërmjet email zyrtar;                                                                                                                                                                                                                                     | Drejtorja e Burimeve Njerezore dhe Shërbimeve Mbështetëse.<br>Gjashtëmujori i dytë i vitit 2025         |  |
| 4 | Përditësimi i njohurive të personelit të bashkisë mbi Ligjin për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen dhe hartimi dhe miratimi i rregullores së brendshme mbi procedurat e sinjalizimit. | Operacional/<br>Procesi | I Mesëm | 1. Realizimi i trajnimeve të domosdoshme për procesin e hetimit dhe shqyrtimit administrativ të sinjalizimeve për praktika apo veprime të dyshuara korupsioni, për stafin e AB-së, të ofruara nga ASPA apo ILDKPKI;<br>2. Organizimi i trajnimeve të brendshme për personelin e bashkisë;<br>2. Rikujtesë periodike e punonjësve mbi funksionin dhe kontaktin e sinjalizuesit; | Sektori i Auditit të Brendshëm<br>Burimet Njerezore, I.T<br>Gjashtëmujori i dytë i 2025 dhe në vijimësi |  |

|   |                                                                                                                                  |                                      |         | 3. Publikimi i rregullores në PT-së bashkisë;                                                                                                                                                                                       |                                                                                                                                                |
|---|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 5 | Mungesa e regjistrimit për deklarimin e dhuratave në bashki.                                                                     | Operacional/<br>Procesi              | I Lartë | 1. Krijimi i regjistrimit për deklarimin e dhuratave në bashki;<br>2. Informimi i personelit në lidhje me krijimin e regjistrimit dhe detyrimet që lidhen me deklarimin e dhuratave;                                                | Drejtoria e Burimeve Njerëzore.<br><br>Gjashtëmujori i dytë 2025                                                                               |
| 6 | Njohuri të papërditësuara të stafit për legjislacionin dhe procedurat për parandalimin dhe deklarimin e konfliktit të interesit. | Burimet<br>Njerëzore/<br>Operacional | Mesatar | 1. Informimi i punonjësve të bashkisë mbi detyrimet e tyre për deklarimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit përkatës dhe kuartrit rregullator të bashkisë;                                                            | Drejtoria e Burimeve Njerëzore/Drejtoria Juridike dhe Prokurimet<br><br>Gjashtëmujori i parë i 2026                                            |
| 7 | Mungesë e njohjes me rregullave për veprimtaritë e jashtme të punonjësve dhe deklarimin e tyre                                   | Operacional/<br>Procesi              | I Mesëm | 1. Parashikimi i qartë në Rregulloren e Brendshme të rregullave etike për veprimtaritë e jashtme të punonjësve të bashkisë/ ose përfshirja në Kodin e Sjelljes së Bashkisë;<br>2. Njohja e personelit të bashkisë me këto rregulla; | Drejtoria e Burimeve njerëzore dhe Autoriteti përgjegjës për Konfliktin e Interesit në Bashki<br><br>Gjashtëmujori i dytë i 2025 e në vijimësi |
| 8 | Mungesa e PSV-ve dhe gjurmëve të auditimit për të gjitha llojet e auditimit të kryer.                                            | Operacional/<br>Procesi              | I Lartë | 1. Hartimi i një plani për zhvillimin e PSV-ve dhe gjurmëve të auditimit për të gjitha llojet e auditimit;                                                                                                                          | Njësia e Auditimit të Brendshëm<br><br>Gjashtëmujori i parë 2026 e në vijimësi                                                                 |

|    |                                                                                                                            |                             |         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                   |  |
|----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|---------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
| 9  | Mungesë vlerësimi i jashtëm periodik mbi performancën e bashkisë lidhur me integritetin dhe transparencën.                 | Operacional/<br>Strategjik  | I Mesëm | 1. Hartimi i një sondazhi me pyetësorë për vlerësimin e integritetit dhe transparencës;<br>1. Hartimi dhe Publikimi i raportit me gjetjet dhe rekomandimet;                                                                                                                                                                                                                      | Koordinatori i Integritetit OSHC, Forumi OGP, Koordinatori i Performancës<br>Gjashhtëmujori dytë 2026<br>Drejtoria e Finances                                                                                                                     |  |
| 10 | Mungesa e dokumentit të Strategjisë së Menaxhimit të Pronave. Zhvillimi i pronave dhe planifikimi afatmesëm dhe afatgjatë. | Operacional /<br>Strategjik | I Lartë | 1. Përcaktimi i kriterëve për zhvillimin e Dokumentit të Strategjisë së Administrimit të Pronave;<br>2. Hartimi, miratimi dhe publikimi i Dokumentit të Strategjisë së Pronave;                                                                                                                                                                                                  | Grup pune me punonjës të bashkisë dhe përfaqësues nga Drejtoria e Pasurive të Paluajtshme<br>Gjashhtëmujori i parë i 2028-it.                                                                                                                     |  |
| 11 | Krijimi dhe publikimi i donacioneve dhe funksionimin e regjistrit përkatës.                                                | Operacional /<br>Ligji      | I Ulët  | 1. Hartimi dhe miratimi i rregullave për pranimin, regjistrimin dhe kontabilizimin e donacioneve (duke përfshirë detyrimin e lidhjes së marrëveshjeve në çdo rast; detyrimin për publikim) etj;<br>2. Krijimi i një regjistri për evidentimin e donacioneve në CASH, aktive, shërbime të kushtëzuara ose jo (me elementë të tillë si: subjektet, donacioni, kushtet nëse ka etj; | 1. Grup pune teknik për hartimin e këtyre rregullave me anëtarë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore + Drejtoria e Koordinimit me Donatorët + Drejtoria Juridike<br>2. Drejtoria e Koordinimit me Donatorët<br>Drejtoria e Finances. |  |



|    |                                                                                                                                   |                         |  |         |                                                                                                                                                                                                     |                                                                                                    |  |
|----|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|--|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
|    |                                                                                                                                   |                         |  |         |                                                                                                                                                                                                     | Gjashtëmujori i parë 2026                                                                          |  |
| 12 | Mungesë e një procedurë standarde për ekspertizë të jashtme për prokurimet e institucionit.                                       | Operacional/<br>Procesi |  | I Mesëm | 1. Hartimi i darft-Manualit.<br>2.Mmiratimi dhe trajnimi i punonjësve të Njësisë së Prokurimeve;                                                                                                    | 1. Sektori i Prokurimeve Gjashtëmujori i dytë 2026                                                 |  |
| 13 | Mungesë e një mekanizmi që mat perceptimin publik për përcaktimin e indeksint vjetor të besimit publik.                           | Operacional/<br>Procesi |  | I Mesëm | 1. Përgatitja e pyetësorit lidhur me perceptimin public;<br>2. Kryerja e sondazheve dhe e raportit;<br>3. Publikimi në faqen zyrtare të bashkisë i rezultateve;                                     | Koordinatori i Performances, OSHC, Forumi OGP, Gjashtëmujori i dytë 2026 e në vijimësi.            |  |
| 15 | Mungesë e deklarimit periodik të Konfliktit të Interesit<br>këshilltarëve/komisionev dhe anëtarëve të KB përpara cdo vendimarrje. | Operacional/<br>Procesi |  | I Mesëm | 1.Ngritja e një grupi pune ad-hok për verifikimin periodik të deklarimit të konfliktit të interesit;<br>2.Publikimi i raportit në Programin e transparencës;                                        | Sekretaria e KB DBNJ Gjashtëmujori i parë 2027                                                     |  |
| 16 | Mungesë e rregullave të brendshme për shmangien e Konfliktit të Interesit në ofrimin e shërbimeve publike.                        | Operacional/<br>Procesi |  | I Lartë | 1. Përfshirja në rregulloren e KI të rregullave mbi parandalimin e KI në fushën e shërbimeve publike.<br>2. Informimi i punonjësve të sektorit mbi Rregulloren e KI përmes trajnimeve të dedikuara; | Drejtoria Juridike, dhe Burimeve Njerëzore dhe T.I.K.<br>Gjashtëmujori i dytë 2025, e në vijimësi. |  |



**Objektivi 2: Forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkëlqjeve të integritetit nëpërmjet konsolidimit të menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore në bashki;**

| Nr. | Risku dhe ngjarjet e mundshme                                                                                  | Kategoria e faktorëve të riskut; | Prioritet i lartë;<br>Prioritet i moderuar;<br>Prioritet i ulët; | Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës;                                                                                                                        | Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteteve;                                                           |
|-----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------|------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 17  | Nevojë për trajnime të vazhdueshme mbi ndryshimet e shpeshta ligjore/nënligjore në fushën e prokurimit publik. | Operacional/Stra tegjik          | I Lartë                                                          | 1. Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve mbi ndryshimet ligjore në fushën e prokurimit publik, në bashkëpunim me ASPA-n dhe APP;                                                  | Drejtoria Juridike, Prokurimeve Publike dhe Burimeve Njerëzore/<br>Drejtoria e Financës dhe Buxhetit<br><br>Gjashtëmujori parë i 2026 dhe në vijim. |
| 18  | Mungesa e një plani të detajuar veprimi me afate konkrete për publikimin e pozicioneve të lira.                | Operacional / Ligjor             | I Mesëm                                                          | 1. Hartimi i planit me afatet kohore konkrete i shoqëruar me përshkrimin e pozicioneve të punës;<br>1. Njoftimi dhe dërgimi i tij pranë KMSHC në zbatim të procedurave ligjore; | Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Burimeve Njerëzore<br><br>Gjashtëmujori i dytë 2025 e në vijimësi.                                            |
| 19  | Mungesa e një plani vjetor trajnimesh për zhvillimin profesional të personelit të bashkisë.                    | Operacional/ Procesi             | I Mesëm                                                          | 1. Përcaktimi në Rregulloren e Brendshme i detyrimit për hartimin e Planit Vjetor të Trajnimeve;<br>2. Përcaktimi në Rregulloren e Brendshme i detyrimit për kryerjen e         | Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse<br><br>Gjashtëmujori i dytë 2025 e në vijimësi.                                           |

|    |                                                                                                                |                         |         |                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                                                                                                    |  |
|----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|---------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------|--|
|    |                                                                                                                |                         |         | <p>Analizës Vjetore të Performancës, si bazë për identifikimin e nevojave për trajnim dhe Hartimin e Planit Vjetor të Trajnimeve;</p> <p>3. Hartimi i Planit të Brendshëm të Trajnimeve dhe Analizës së Performancës, çdo vit;</p> <p>4. Informimi i personelit mbi këtë plan;</p> |                                                                                                    |  |
